



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 57
Prishtinë, më 19 prill 2012

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 19 PRILL 2012**

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmoi nënkryetari **Xhavit HALITI**.

Kryetari, deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe i filloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pasurimin e miellit,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat,
6. Shqyrtimi i Raportit të parë për zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, për vitin 2012,
7. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës, për vitin 2011,
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2011,
9. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2011,
10. Shqyrtimi i strategjisë dhe planit të veprimit kundër korrupsionit, për vitet 2012-2016.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Teuta Haxhiu, Fadil Demaku, Hashim Deshishku, Liburn Aliu, Ganimete Musliu, Emilija Rexhepi, Gëzim Kelmendi, Burim Ramadani, Alma Lama, Jakup Krasniqi, kryeministri Hashim Thaçi, Sabri Hamiti, Ardian Gjini, Berat Buzhala dhe Ismet Beqiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në lidhje me diskutimet dhe replikat në këtë pikë të rendit të ditës, kryetari iu referua nenit 48 të Rregullores së Kuvendit.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Blerta Deliu-Kodra, parashtoi pyetje për ministrin Dardan Gashi, në lidhje me veprimet që ka ndërmarrë Ministria që ai drejton për zvogëlimin e ndotjes së mjedisit në Kosovë.

Ministri Dardan Gashi, iu përgjigj pyetjes së deputetes Blerta Deliu-Kodra.

Deputetja Blerta Deliu-Kodra parashtoi pyetje për ministrin Ramë Buja, në lidhje me lirimin nga pagesa për konvikt të anëtarëve të organizatave studentore dhe si mund t'u privohet kjo e drejtë familjarëve të dëshmorëve dhe kategorive të tjera?

Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetes Blerta Deliu-Kodra.

Deputetja Ganimete Musliu, parashtoi pyetje për ministrin Ramë Buja, në lidhje me rolin e Ministrisë që ai drejton në disiplinën e profesorëve të UP-së.

Ministri Ramë Buja, iu përgjigj pyetjes së deputetes Ganimete Musliu.

Deputetja Alma Lama parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi, në lidhje me atë se pse Qeveria nuk e ka sjellë në Kuvend Projektligjin për legalizimin e ndërtimeve pa leje.

Kryeministri nuk ishte prezent në sallë.

Deputetja Time Kadrijaj, parashtoi pyetje për ministrin Nenad Rashiq, në lidhje me atë se a ka dështuar Ministria që ai drejton gjatë hartimit të Ligjit të punës?

Ministri Nenad Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputetja Kimete Bytyçi, parashtoi pyetje për ministrin Fehmi Mujota, në lidhje me mosasfaltimin e deritashëm të rrugës Maqitevë-Dobërdolan-Pagarushë-Nishor, dhe kur planifikohet asfaltimi i saj.

Ministri Fehmi Mujota iu përgjigj pyetjes së deputetes Kimete Bytyqi.

Deputetja Time Kadrijaj, parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani, në lidhje me vendimin që pacientet e gjinisë femërore të trajtohen nga mjeket femra, dhe sa mjete janë ndarë për punësimin e gjinekologeve dhe mjekteve tjera femra?

Ministri nuk ishte prezent në sallë.

Deputeti Ramiz Kelmendi, parashtoi pyetje për ministrin Bedri Hamza, në lidhje me përfundimin e procesit të fiskalizimit të bizneseve në Kosovë.

Ministri Bedri Hamza, iu përgjigj pyetjes së deputetit Ramiz Kelmendi.

Deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj, parashtoi pyetje për ministrin Nenad Rashiq, në lidhje me mosrespektimin e Ligjit të punës.

Ministri Nenad Rashiq, iu përgjigj pyetjes së deputetes Rita Hajzeraj-Beqaj.

Në bazë të nenit 46 të Rregullores së Kuvendit, ministri Ramë Buja ka dhënë përgjigje me shkrim, në pyetjen e deputetit Enis Kervan nr. 04/2211/DO-930 dt. 5.4.2012.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur më 12 prill 2012

Kuvendi, miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes plenare të datës 12 prill 2012

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pasurimin e miellit

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për pasurimin e miellit.

Ministri **Blerand Stavileci** tha se ky projektligj përcakton rregullat për pasurimin e miellit me hekur dhe acid folik, si dhe cilësi dhe siguri të miellit të pasuruar gjatë deponimit, transportimit dhe shitjes.

Në vazhdim ai theksoi se projektligji adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me strukturën complete gjithëpërfshirëse dhe përmbajtësore që shtjellohet në tre kapituj.

Më pas ai u fokusua në aspekte tjera të këtij projektligji, në strukturën e tij dhe në harmonizimin e tij me legjislacionin e BE-së.

Në fund, ministri Blerand Stavileci i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim, Projektligjin për pasurimin e miellit.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për pasurimin e miellit.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Nait Hasani , në emër të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Nijazi Idrizi , në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sali Morina , në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Liburn Aliu , në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, Time Kadrijaj , në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Sevdije Lama , në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Goran Marinković , në emër të Grupit Parlamentar SLS,ndërsa Rasim Demiri, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe deputetët: Shaip Muja, Nazane Breca, Aurora Bakalli dhe Bekim Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për pasurimin e miellit
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 58,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim Projektligjin për pasurimin e miellit

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si Komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, e arsyetoi kryetarja e këtij komisioni, deputetja, Safete Hadergjonaj.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, dhe amendamentin nr. 19.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	58,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

6. Shqyrtimi i Raportit të parë për zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, për vitin 2012

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit për Integritet Evropian, të paraqesë para deputetëve raportin e parë për zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës, për Integritet Evropian, për vitin 2012.

Deputeti **Lutfi Haziri** tha se Kuvendi çdo tre muaj diskuton për zbatimin e këtij plani dhe paraqet raport për zbatimin e tij nga ana e trupave të Kuvendit, për periudhën tremujore të paraparë sipas planit të veprimit të Kuvendit për integritet evropian për vitin 2012.

Në vazhdim tha se gjatë këtij tremujori të vitit 2012 është arritur progres në disa fusha, që janë paraparë të realizohen në këtë plan, ndërsa mbetet akoma më shumë për t'u bërë, sidomos nga komisionet parlamentare lidhur me mbikëqyrjen e dikastereve të Qeverisë.

Më tej deputeti Lutfi Haziri, u fokusua në përmbajtjen e raportit të parë për zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, për vitin 2012.

Në fund ai kërkoi miratimin e raportit të parë për zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, për vitin 2012.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, të raportit të parë për zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, për vitin 2012.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Suzan Novoberdaliu , në emër të Komisionit për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, Blerta Deliu-Kodra , në emër Grupit Parlamentar të PDK-së, Vjosa Osmani , në emër të Grupit

Parlamentar të LDK-së, Alma Lama, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Idriz Vehapi, në emër të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Time Kadrijaj, në emër të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Safete Hadergjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa si dhe deputetët: Xhevdet Neziraj, Hydajet Hyseni, Zenun Pajaziti, Salihe Mustafa dhe Lutfi Haziri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij raporti.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 62,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi raportin e parë për zbatimin e planit të veprimtari të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, për vitin 2012.

7. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës, për vitin 2011

Deputeti **Zenun Pajaziti**, në emër të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri tha se si komision kemi shqyrtuar raportin vjetor të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës, për vitin 2011 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai në fund përkrahu raportin vjetor të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës, për vitin 2011.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e raportit vjetor të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës, për vitin 2011.

Raportin vjetor financiar të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës, për vitin 2011, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, e paraqiti deputetja, Safete Hadergjonaj.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hashim Dëshishku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Biserka Kostiq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, ndërsa Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Sala Berisha-Shala, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e raportit vjetor të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës, për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 57,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi raportin vjetor të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës, për vitin 2011.

8. Shqyrtimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2011

Deputetja **Safete Hadergjonaj**, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, arsyetoi rekomandimin e Komisionit lidhur me Raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2011.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2011.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Hasime Krasniqi , në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albana Fetoshi , në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Burim Ramadani , në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Muhamet Mustafa - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Ali Sadriu, në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ministri Fehmi Mujota, Kurtan Kajtazi dhe Hykmete Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e raportit vjetor të së Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 54,
Kundër----- 7,
Abstenime----- 6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2011.

9. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2011

Deputetja **Safete Hadergjonaj**, në emër të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, tha Komisioni ka shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2011 dhe kanë rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin e tij në mbledhje plenare.

Ajo në fund përkrahu raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2011.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2011.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Hasime Krasniqi , në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albana Fetoshi, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Muhamet Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Ali Sadriu dhe Muhamet Mustafa, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 54,
Kundër----- 4,
Abstenime----- 8.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2011.

10. Shqyrtimi i strategjisë dhe planit të veprimit kundër korrupsionit, për vitet 2012-2016

Kryetari tha se Komisioni për Legjislacion ka shqyrtuar Strategjinë dhe Planin e veprimit kundër korrupsionit, për periudhën 2012-2016, dhe Kuvendit ia ka paraqitur rekomandimin për shqyrtim në mbledhje plenare.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e strategjisë dhe planit të veprimit kundër korrupsionit, për vitet 2012-2016.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Behar Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Vjosa Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Burim Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Fatmir Xhelili, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Sabri Hamiti dhe Jakup Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputeti Bekim Haxhiu diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës, e dorëzoi me shkrim.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e strategjisë dhe planit të veprimit kundër korrupsionit, për vitet 2012-2016.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 19,
Kundër----- 39,
Abstenime----- 6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

Kuvendi nuk miratoi Strategjinë dhe Planin e veprimit kundër korrupsionit, për periudhën 2012-2016.

Kryetari konstatoi të mbyllur punimet e mbledhjes së sotme, në ora 19:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale